

Anton Çetta

PËR NJË NDARJE MË TË PLOTË TË PROZËS POPULLORE DHE EMËRTIMIN E CA LLOJEVE TË SAJ

Hyrje

Kur flasim për periodizimin e letërsisë shqipe,¹ na paraqitet një kërkesë po aq e nevojshme, një punë që duhet kryer paralelisht me të—periodizimi i letërsisë gojore, zgjidhja e të cilit do të na lehtësojë studimin e kësaj të fundit në mënyrë më sistematike.

Por, ndërsa me rastin e periodizimit të letërsisë artistike bëhet fjalë për zhvillimin dhe ndarjen e saj ç'prej gjurmëve të para të shkrimit shqip deri në ditët tona, duke e ndarë atë kronologjikisht në etapa të ndryshme sipas brendisë së trajtuar, ideologjisë së reflektuar në të dhe formave në të cilat paraqitet ajo ndër epokat e ndryshme të zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe në rrethanat e periudhat historike që ndikuan dhe lanë mbresa të thella në këtë apo atë periudhë të letërsisë sonë, në letërsinë popullore gojore këtë ecuri të prodhimit folklorik do ta ndjekim vetëm kur bëhet fjalë për ndarjen në etapa, grupe apo cikle të këngëve historike.

Të gjitha elementet e tjera që përbëjnë reflektimin e jetës, të vetë realitetit shoqëror në këtë lloj prodhimi artistik, lidhjet e ngushta të tij me zhvillimin psikik, me formimin e ndërgjegjes, bindjeve dhe botëkuptimeve të shtresave popullore, të pasqyruara nëpërmjet këngëtarit apo tregimtarit anonim popullor, do t'i kundrojmë në tërësi, në elementet jo të rralla, që e përshkojnë dhe e lidhin letërsinë popullore si një fill i përbashkët ç'prej ninullave deri te vajtimet.

Vetë nocionin e periodizimit në letërsinë gojore do ta zgjerojmë sot dhe me kuptimin e klasifikimit të saj, të ndarjes së saj, duke u nisur nga dy format kryesore të kësaj ndarjeje, në poezi dhe në prozë popullore, gjer në llojet e ndryshme që përfshihen në to, siç është vepruar madje edhe gjer më sot.

¹ Kjo kumtes u lexua në Sesionin shkencor që mbajti Instituti Albanoogjik i Prishtinës më dt. 7 dhe 8 maj 1973 me temën: *Çështje rreth periodizimit të letërsisë shqiptare.*

Në këtë kumtesë do të kufizohem vetëm në ndarjen e prozës popullore, konkretisht, do të orvatem të bëj të bindshme para këtij forumi disa qëndrime të mia të mëparshme përsa i përket zgjerimit të ndarjes së prozës popullore me disa lloje të reja dhe emertimin e tyre, i bindur se njohja dhe pranimi i këtyre llojeve do të na lehtësojë punën në mbledhjen e materialeve folklorike e sidomos në paraqitjen e këtyre materialeve në mënyrë më shkencore, mu sot, kur i jemi përveshur një detyre të rëndësishme dhe të gjerë — mbledhjes dhe botimit sistematik dhe sa më të plotë të folklorit tonë.

I. NDARJA DHE EMËRTIMET E GJERTANISHME TË LLOJEVE TË PROZËS POPULLORE

Klasifikimi dhe emërtimet e llojeve të prozës sonë popullore erdhën duke u bërë dalngadalë gjatë vitesh, madje dhe pa një qëllim të caktuar që të bëhej klasifikimi si klasifikim, si një kërkesë shkencore, por u bë, më mirë të them, u plotësua gradualisht, ashtu siç mblidheshin shkallë-shkallë dhe vetë materialet folklorike në prozë nga shkencëtarët dhe dashamirët e letërsisë sonë gojore. Ja shkurtimisht dhe ndarja dhe emërtimet e para të llojeve të prozës popullore ç'prej fillimit gjer në ditët tona:

Ç'prej vitit 1635 kishim pasur *proverbet* e para shqipe në atë tubëz 113 njësish që F. Bardhi i quan proverba dhe sentenca.² Do të kalojnë dy shekuj të kemi 6 *përralla*, të parat që i njohim („Përralla popullore toskërishte”), të mbledhura nga Hahni³ dhe ca *gjë e gjëza, fjalë të urta* dhe frazeologji, të cilat Hahni i quan *fraza*, sikurse quhen dhe në dorëshkrimin e Pragës të Th. Mitkos. Dhe kështu me radhë e në një proces të ngadalshëm do të na paraqiten lloje të reja të mbledhura nga folkloristët e tjerë. Jarniku na jep, pos të tjerash, dhe disa *anekdota*.⁴ Te Pedersen⁵ gjejmë dhe ca *besime popullore* (bestytni), ndërsa te Majeri⁶ kemi *fabula* dhe dy *histori shtrigash* (VI). Për shtrigat si dhe për lugetër, drangoj, shtojzavalle etj., do të paraqesë më vonë materiale shumë të pasura Lamerci në përmbledhjen „Albanesische Märchen”.⁷ Majeri na la materiale shumë të pasura folklorike në dy blejt V dhe VI të veprës „Albanesische Studien”. Në blenin VI, çka na interson ne, në kapitullin a), ka „proverba dhe shprehje proverbiale nga Shkodra”. Ndoshta Majeri termin *shprehje proverbiale* e ka shënuar në mënyrë të pavetëdijshme. Dhe vetë shembujt janë të paktë, faqe të paktë. Megjithatë, ky ndryshim që bën ai në mes të proverbit dhe të shprehjes proverbiale do të na interesojë më vonë. Ja dhe nja dy shembuj nga ky grup i shprehjeve proverbiale: „Mirë â njeri mos me pi, se prish menen e vet e erzin e vet”, „Rakija në fuçi rri rahat; kur ta pish, shkon në krye e vëlon si ui në zierm,

² *Dictionarium latino-epiroticum*, per Franciscum Blancum, Roma 1635, cap. VIII *Proverbia*, § *sententiae Epirotorum*, f. 207.

³ J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena — Wien 1853-54.

⁴ Jan Urban Jarnik, *Zur albanischen Sprachkunde*, Leipzig 1881.

⁵ Holger Pedersen, *Albanesische texte mit glossar*, Leipzig 1895.

⁶ Gustav Meyer, *Albanesische Studien*, Wien V, 1896 dhe VI, 1897.

⁷ Maximilian Lambertz *Albanesische Märchen*, Wien 1922.

e bie(r) erzim e gján”.⁸ Te Mitkua,⁹ përposë të tjerash, gjejmë të mbledhura përshëndetjet, të cilat në një sasi minimale i kishim pasur dhe te Bardhi. Mitkua i quan të përshëndoshura, ndërsa në kapitullin d) „Këngë të vjetra” (alegorike dhe për të qeshur) në Nr. 13, do të gjejmë një pjesë që nuk është në vargje, por në prozë: „Ç’e bëre mishtë, moj nuse?” (Mbledhës të Her. të folkl. shqipt. bl. II, f. 39). Ndonse Mitkua nuk cakton një emër të veçantë për këtë njësi folklorike në prozë, ai ka meritën ta ketë shënuar atë i pari. Më vonë Spiro Dine¹⁰ përdor termin *lodra* për „këngët e fëmijëve”, të cilat, në blenin e Këngëve popullore lirike, Tiranë 1955, janë quajtur „vargje fëmijësh.” Vetë Dinoja e shënon të njëjtën prozë të Mitkos „Ç’e bëre mishtë, moj nuse?” dhe e shtien në kapitullin XI(60) „Alegorika”. Ndonse ky term më duket krejtësisht i pavend, te Dineja do të gjejmë një tjetër term që mund të na interesojë më vonë — termin që zgjedh për kapitullin X „Lodra”, në të cilin kapitull ai rendit këngët e fëmijëve apo „vargje fëmijësh” siç janë quajtur së voni në blenin „Këngë popullore lirike”, botuar nga Instituti i Shkencave, Tiranë 1955.

Te Spiro Dineja do të gjejmë dhe një tjetër lloj të prozës popullore, nga i cili ai shënon për herë të parë tri proza dhe këtë lloj e quan: „Dhesidhemonia¹¹ në Shqipëri” (XV/b). Në të ai rendit tri tregime popullore: „Qyqeja”, „Gjoni” (zog që këndon natën—e shpjegon Dineja) dhe tregimin e tretë „Zogu verdhoshi”. Është fjala për tregime që kanë të bëjnë me metamorfozimin e njerëzve në shpend, të cilët shpend mbajnë dhe sot në këto tregime emrat që kishin dikur si njerëz. Ndonse metamorfozime të ndryshme kemi dhe në përralla si dhe në ndonjë baladë, ato kanë një rëndësi episodike, kurse në këto tregime përbëjnë momentin kryesor, thelbin e vetë tregimit. Më vonë u botua dhe ndonjë tregim i këtillë në blenin „Folklorë”, I, (Shkodër 1940), psh. ai i pulës shndërruar në breshkë. Në këtë rast, si nëntitull përdoret termi *kallxim*, i cili përdoret më vonë zakonisht dhe për tregimet e ndryshme që ndodhen në blenin „Folklorë II, ndër malet tona” (Shkodër 1940), për tregime llojesh të ndryshme, qofshin ato anëkdota, fabula, gojëdhana (Sh. Guri i nrikullës, Shoka e kumarës) apo tregime etnografike (N’dorë tande skjapi i kumbonës) etj. Ne do të na interesojë më tepër termi „kallxim”, të cilit më vonë do t’i japim një kuptim të caktuar, ndonëse në këta dy blejt e fundit, Folklorë I dhe II ky term shfaq nocionin e tregimit popullor në përgjithësi, pa bërë dallime.

Në botimet e mëvonshme të materialeve folklorike meritojnë të përmenden *gojëdhanat*, të mbledhura nga Shtjefën Gjeçovi dhe të botuara në „Albania” (1905-1906) me titullin „Gojëdhanat për Skënderbeun”, pastaj dhe në blenin „Skënderbeu simbas gojëdhanash” të Marin Sirdanit (1926). Më vonë do ta gjejmë përsëri këtë term në blenin XX të Visareve të Kombit (Tiranë 1939), në të cilin ndodhen: një gojëdhanë për Skënderbeun dhe dy të tjera me shpend („Kumrija e qokthi” dhe „Gjoni, Gjini e qyqja”). Në këtë ble

⁸ Shembujt janë nxjerrë nga përmbledhja e Institutit të Folklorit: *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar* (1635-1912) I, Tiranë 1961. Nga ky ble i parë dhe nga i II dhe i III kemi nxjerrë dhe shënimet e tjera për këtë pjesë informative të kumtesës, nga se na kanë munguar veprat origjinale.

⁹ Thimi Mitko, *Bleta shqiptare*, Aleksandri 1878.

¹⁰ Spiro Dine, *Valët e detit*, Sofje 1908.

¹¹ Nga greq. — bestytni.

do të gjejmë dhe termin *enigma*, me të cilin përfshihen gjëgjëzat. Poashtu në këtë ble materialesh folklorike përfshihen dhe disa fjalë të rralla në kapitullin I „Fjalë” (f. 5-21) si dhe fjalë të urta e lokucione.

Kjo është terminologjia e përdorur nga shkencëtarët dhe dashamirët e folklorit tonë ndër botimet e tyre gjer në fund të Luftës II Botërore, terminologji kjo, siç e pamë, e përdorur herë-herë dhe pa vend, apo që lë shtek të diskutohet.

*
* *
*

Pas Çlirimit dhe pas formimit, në fillim, të Komisionit të Folklorit e më vonë të Sektorit të Folklorit pranë Institutit të Shkencave, sot i shndërruar në Institutin e Folklorit të Tiranës e në Arkivin e Folklorit, ku ekzistojnë materiale tejet të pasura nga proza popullore, fryt ky i një pune sistematike të mbledhjes së folklorit në R.P. të Shqipërisë, dhe pas krijimit të Institutit Albanologjik të Prishtinës, i cili poashtu, ndonëse në fazën fillestare, është duke tberë një punë sistematike për mbledhjen e materialeve folklorike ndër shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, kjo punë e dendur në lëmin e folklorit shqiptar ka dhënë frytet e dëshirueshme. Më se dhjetë blej materialesh folklorike që danë parë dritën në Tiranë dhe dy-tre blej me materiale folklorike që do të alin nga shtypi pas një kohe jo shumë të gjatë si botime të Institutit Albanologjik të Prishtinës, dhe perspektiva shumë e mirë që në vitet e ardhshme të kemi botime më të shumta materialesh të letërsisë sonë gojore, na paraqesin si detyrë të ngutshme shkencore, ndërmjet të tjerash, dhe mbajtjen e kriterëve më rigorozë si dhe një qëndrim më studioz në klasifikimin e letërsisë gojore në përgjithësi, e, çka na intereson ne sot, në ndarjen më të plotë të prozës popullore dhe në emërtimin e disa llojeve të saj.

Pasi paraqita ndarjen e prozës popullore dhe emërtimin e llojeve të saj deri në Luftën II Botërore, punë kjo e kryer individualisht, të shohim se si është bërë ndarja dhe si janë dhënë emërtimet e llojeve të prozës popullore nga shkencëtarët dhe studjuesit e folklorit shqiptar në Tiranë. Rezultatet e punës së tyre kolektive pas Luftës II Botërore janë paraqitur në Historinë e letërsisë shqipe,¹² dhe në Dispensat e Universitetit të Tiranës.¹³ Këtu do të gjejmë në të vërtetë studimet e para analitike të folklorit shqiptar në përgjithësi, pra dhe të prozës popullore, të pasuruara më vonë dhe me trajtesa e artikuj të tjerë, të botuar si hyrje në vëllimet e materialeve folklorike, pregatitur nga punonjësit shkencorë të Institutit të Folklorit.

Duhet të theksoj me këtë rast faktin se, në këto studime, prozës popullore i është kushtuar një vend, e, ma merr mendja, dhe një kujdes më i vogël se sa poezisë popullore. Sidoqoftë, llojet e prozës popullore, për të cilat bëhet fjalë në ato studime, janë këto:¹⁴

¹² U. Sh. T. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Historia e letërsisë shqipe*, II, Tiranë 1959, pjesa e parë, *Folklori shqiptar*, f. 3-136

¹³ Universiteti i Tiranës, Instituti i Folklorit, *Folklori shqiptar*, Tiranë 1972, f. 300.

¹⁴ Këto lloje të prozës popullore janë të paraqitura në të njëjtën renditje siç ndodhen dhe në Historinë e letërsisë shqipe, I, si dhe dispensat e Universitetit të Tiranës, *Folklori shqiptar*, Tiranë 1972.

1. *Proverbat* me një degëzim të *ofiqeve*.
2. *Gjëzat* (apo *gjëgjëzat*).
3. *Përrallat* — a) mitologjike, fantastike.
b) aventuroze, novelistike e realiste.
4. *Legjendat* ose *gojëdhanat* — a) toponimesh
b) personazhesh historike,
c) personazhesh fetare dhe mitologjike,
5. *Fabulat*
6. *Anekdotat*

Ne tekstin shkollor për shkollat e mesme „Folklori Shqiptar“ Tiranë 1964, përposë llojeve të përmendura më sipër, bëhet fjalë dhe për:

7. *Frazeologjitë* e
8. *Përshëndetjet*.

Ndërsa, në një botim të Institutit të Folklorit „Kujtime dhe këngë popullore për Luftën çlirimtare të viteve 1918-1920“, Tiranë 1970, nuk shënohet nëse këto *kujtime* janë konsideruar si njësi folklorike apo historike.

Këto janë llojet e prozës popullore, që konsideroheshin si normative gjer para një viti.

Çfarë plotësimesh do të na sillte ndarja e re dhe emërtimet e reja të llojeve të prozës popullore?

II. PËR PLOTËSIMIN E NDARJES DHE TË EMËRTIMEVE TË LLOJEVE TË PROZËS SONË POPULLORE

Para se të kalojmë në shqyrtimin e këtij problemi desha të theksoj se, për të pasur një ndarje sa më konsekuente dhe më të plotë, duhet të mbështetemi në disa elemente të rëndësishme që i veçojnë njësitë e ndryshme folklorike si lloje më vete, siç janë: *përmbajtja* e *forma* (të dhëna në mënyrë koncize në vetë definicionin e këtyre llojeve) si dhe *mënyra e të treguarit* (në ndonjë rast të rrallë).

Njëkohësisht, gjatë punës sonë, duhet të mos ngurrojmë e të mos frikësohemi se mos po bëjmë ndonjë hap të gabueshëm nëse largohemi ndopak nga format e vjetra, të njohura mirë. Sepse, disa materiale të reja, të zbuluara ose të mbledhura në kohët e fundit, na imponojnë të krijojmë lloje të reja të prozës popullore e të gjejmë dhe emërtime të reja që përpara nuk i kishim, ngase nuk njiheshin as vetë materialet, ose njiheshin në një numër fare të kufizuar.

Krijimet folklorike në prozë do t'i ndajmë së pari në dy grumbuj kryesorë: Tregimet popullore dhe llojet minore të prozës popullore.

a) Me termin *tregime popullore* do të përfshijmë ato proza popullore që kanë kryesisht etapat e syzheut — të paraqiturit e veprimit, thurja e veprimit, kulminacioni, peripetia dhe çthurja e veprimit. Shembuj të këtillë të plotë kemi sidomos në prozat më të gjata popullore, siç janë përrallat, kallë-

zimet etj. Ca tregimeve të tjera popullore, atyre më të shkurtërave, ndodh t'u mungojë ndonjë nga këto elemente, p.sh. përfundimi, i cili shpesh konsiston jo në një episod, por në një fjali të shkurtër apo në një lojë fjalësh. Mund t'i mungojë dhe të paraqiturit e veprimit, madje dhe çthurja e veprimit apo dhe ndonjë tjetër nga etapat e syzheut të jenë të zbrazëta, të varfëra. Të këtilla, në ca raste, janë përrallëzat dhe anekdotat.

b) Në llojet minore të prozës popullore do të përfshijmë ato krijime folklorike, të cilave u mungojnë etapat e syzheut. Ato paraqiten si formula të shkurtëra e koncize, qoftë për të shprehur një mendim, gjykim, këshillë apo urti (fjalët e urta) qoftë ndonjë enigmë për t'u zgjidhur (kashelashat), qoftë shprehje të qëlluara metaforike apo dëshira, që njeriu i thjeshtë i popullit ka ditur t'i formulojë bukur në frazeologjizmat, urimet e të tjera deri te dollitë.

a) Tregimet popullore

1. Të nisemi nga *përrallat*, si krijime shumë të vjetra popullore në prozë. Do ta ruajmë emërtimin e gjertanishëm, si të vetmin që njihet në popull. Do të pranojmë definicionin e përshtatshëm që është dhënë për to: „Përralla është një kallëzim popullor me karakter të theksuar fantastik”.¹⁵ *Pra fantastiku (episodet dhe qeniet ireale) është faktori që cakton natyrën e tyre*. Ndërsa, sa i përket formës, — ato dallohen si *tregime të gjata popullore*.

Por, duke ruajtur një term të vetëm, përbri përrallave me karakter të theksuar fantastik, janë vënë përrallat aventuroze, novelistike, realiste. Ndryshimi në vetë natyrën e tyre pranohet, madje dhe theksohet, por ndarja e tyre në dy lloje të ndryshme tregimesh popullore nuk bëhet. Në qoftë se pranojmë ndryshimin në vetë natyrën e tyre (gjë që dhe duhet ta pranojmë) ç'na mbetet e përbashkët nga këto dy lloje tregimesh që t'i mbajmë ende së bashku në të njëjtin grup? — Vetëm forma, që konsiston në gjatësinë e tyre të ngjashme. Pra, këto dy lloje tregimesh, të ndryshme për nga natyra dhe përmbajtja — *ireale dhe reale*; të ndryshme për nga thurja — *me elemente dhe episode të mrekullueshme që nuk mund të ngjasin, në një anë, dhe me elemente dhe episode reale, që mund të ngjasin, në anën tjetër*; të ndryshme për nga çthurja e veprimit — *me një „deus ex machina”, në një anë, dhe me një formë të mundshme, në anën tjetër, kanë qëndruar gjer më sot në një lloj të vetëm tregimesh popullore vetëm në saje të një lidhjeje formale të përbashkët — vetëm për shkak të gjatësisë së tyre*. Përndryshe, po të ishim mbështetur në natyrën, në përmbajtjen, në personazhet dhe mjetet, që janë elementet esenciale për klasifikimin e tyre, do t'i kishim ndarë në dy lloje tregimesh popullore. Madje, vetë definicioni që u është dhënë përrallave, si „kallëzime popullore me karakter të theksuar fantastik”, bën të domosdoshme ndarjen e tyre nga tregimet e tjera, gjithnjë aventuristike, por me përmbajtje dhe mjete novelistike, realiste.

¹⁵ Zihni Sako, *Folklori shqiptar për shkollat e mesme*, Tiranë 1963, f. 26. Ose: „përrallat... që kanë në qendrën e tyre personazhe dhe ngjarje të çuditshme, që flasin për vise dhe kohë fantastike”, (U. Sh. T., *Historia e letërsisë shqipe*, I, Tiranë 1959, f. 55).

Prandaj shoh të arsyeshme që, nga ky lloj, gjer tani i përbashkët i prozës popullore, të kemi paskëtaj dy lloje tregimesh popullore:

a) *Përrallat* — tregime popullore me karakter të theksuar fantastik, të thurura me elemente dhe episode ireale.

b) *Kallëzimet* — tregime popullore aventuroze dhe novelistike, të thurura me elemente dhe episode reale.

2. Emërtimit *kallëzim*, i cili ekzistonte më parë në një kuptim të gjërë dhe të pacaktuar mirë — tregim popullor në përgjithësi¹⁶ — tani do t'i japim një kuptim më të kufizuar, atë të novelës popullore, të tregimit aventuroz të thurur me elemente reale.

3. Fabulat nuk njihen në popull me një emër të caktuar. I quajmë „mesele” (anekdota), apo „mesele me gjâ e shpêni” dhe „mesele me mahlukat”¹⁷ etj. Termi „fabulë”, i përdorur gjer më sot në folkloristikën tonë, është huazuar nga latinishtja. Për hir të pastërtisë së gjuhës nuk do të ishte keq të zëvendësohej, në mënyrë konvencionale, me një emërtim thjesht shqip. Mendoj që termi *përrallëz* do të ishte i përshtatshëm.

Shpjegimi i kësaj fjale, që jipet në Fjalorin e gjuhës shqipe (Tiranë 1954) „PËRRALLËZ-A ef, shm. -a përrallë” nuk vë në pah nocionin e zvogëlimit që duhej të sillte prapashtesa *zë* (z). Emri „përrallëz” na del i papërshtatshëm si sinonim i emrit „përrallë”. Sikur të vihej në pah nocioni i zvogëlimit që sjell me vete prapashtesa *zë*(z) — (përrallëz — përrallë e vogël) — do të binim në kundërshtim me vetë formën e llojit folklorik të përrallës, e cila dallohet për nga forma si tregim i gjatë popullor. Në këtë rast shpjegimi nuk do të ishte real.

Përkundrazi, për fabulat emri „përrallëz” do të ishte një term i qëlluar, sepse: a) me një anë emri (rrënja) „përrall(ë)” ngërthen në vete kuptimin e tregimit fantastik, që u përgjigjet dhe fabulave, të cilat, ndonse krijime realiste, prapëseprapë kanë një notë, një element fantastik — që shtazët, shpendët dhe sendet flasin, dhe b) në anën tjetër, prapashtesa e zvogëlimit *zë* (z) i përgjigjet natyrës së fabulës që është kryesisht një tregim popullor shumë i shkurtër, pra, në këtë rast, kjo prapashtesë do të kishte një funksion logjik me vetë formën e këtij lloji tregimi popullor.

Termin *fabulë* do ta mbajmë në kuptimin që ka pasur gjer më sot në beletristikë — fabula e një romani, novele, poeme etj. si dhe në muzikën programatike.

4. *Gojëdhanat*, tregime etiologjike, janë kryesisht të shkurtëra dhe fantastike, që mbështeten në besime, bindje dhe bestytini popullore. Disa nga to kanë për objekt personazhe dhe ngjarje historike. Ato kanë për qëllim të shpjegojnë sipas besimeve popullore, origjinën e ca toponimeve, frymorëve, të bëmave të personazheve historike dhe johistorike dhe të ndonjë dukurie apo fenomeni natyror. Sipas brendisë, personazheve, qenieve dhe objekteve për të cilat flitet në to, do t'i ndajmë në:

¹⁶ Shih: *Folklorë I*, Shkodër 1940 dhe *Folklorë II*, ndër malet tona, Shkodër 1940.

¹⁷ *mahluk* sh. *mahlukat* (arab.) krijesë, gjë e gjallë, shtazë, kafshë.

- a) gojëdhana toponimesh,
- a) " frymorësh (për shtazë, shpend dhe insekte)
- c) " fytyrash historike,
- ç) " fytyrash johistorike (kryesisht për personazhe fetare)
- d) " mitologjike (shih: Shoka e kumarës,¹⁸ Byku i kumarës.)¹⁹

Të botuara edhe nga S. Dineja nën titullin „Dhesidhemonia” (nga greq, e vjetër δεισιδαιμονία — bestyttni) këto tregime u paraqitën për herë të parë me emërtimin e tyre të përshtatshëm nga Sh. Gjeçovi në „Gojëdhanat për Skënderbeun” në të përkohshmen „Albania” (1905-1906), emërtim ky madje që ekzistonte ç’prej kohësh dhe që është shumë i përhapur në popull. Termin „legjendë”, që figuronte përpara në ndonjë tekst normativ,²⁰ do ta përdorim në poezinë popullore për këngët me motiv mitik, me episode fantastike ose me personazhe fetare (shih: Kanga e gjarpnit, Kanga e divit, Ishnjin nëntë vëllazëni etj.).²¹

5. Për vetë anekdotat popullore nuk është nevoja të flitet. Ato i përkasin atij lloji të njohur mirë të tregimeve të shkurtëra, kryesisht humoristike e satirike, gjithnjë realiste dhe që kanë një përfundim të papritur.

Vetë termin *anekdotë*, që është përdorur gjithmonë në folkloristikën tonë dhe në atë botërore, do ta mbajmë. Emërtimin „mesele”, ndonëse është shumë i njohur në popull, do ta mënjanojmë si turcizëm që nuk ka mundur të depërtojë gjer më sot në terminologjinë tonë shkencore, ashtu sikurse nuk kanë mundur të depërtojnë dhe termat: shaka, shpotina, përrallëza (në kup-timin e anekdotës), histori për të qeshur etj.

Ndarja e brendshme e tyre në grupe të vogla, sipas tematikës, është bërë shumë me vend në botimin e anekdotave nga Instituti i Folklorit të Tiranës.²² Me kohë mund t’i bëhen plotësime apo thjeshtime kësaj ndarjeje, mvarësisht nga shija e vetë përpiluesve dhe nga materialet e reja që ata do të kenë në dispozicion.

6. Pleqnia (të pleqnuarit) ishte një institucion i së drejtës zakonore, e cila përbëhej nga një plak ose grup pleqësh të njohur dhe, në prani të dorëzanëve e të dëshmitarëve, zgjidhte disa çështje civile, penale dhe konteste të tjera. Nga këto pleqni, të cilat mbaheshin në kuvend të burrave apo „meshliz, mexhliz”, vlerësohej pesha e deliktit, fajit apo dëmit, caktoheshin sanksionet, duke u mbështetur në normat e së drejtës zakonore, kryesisht të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Nga kjo praktikë e gjykimit, që u ushtrua shekuj me radhë, u dalluan ca raste, të rralla dhe më të vështira për t’u zgjidhur. Madje pleqnitë e kë-tilla, në raste kur mungonin normat e caktuara zakonore, daheshin herë-

¹⁸ Shih, *Folklorë II, ndër malet tona*, Shkodër 1940, f. 55.

¹⁹ Maximilian Lambertz, *Albanische Märchen*, Wien 1922, f. 162.

²⁰ U. Sh. T. *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë 1959, f. 60. Madje vetë hartuesit e këtij teksti e kanë braktisur termin legjendë dhe kanë përvetësuar emërtimin *gojëdhanë* (shih dispensat e U. Sh. T. *Folklori shqiptar*, tekste për Universitetin) Tiranë 1972, f. 177.

²¹ Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Balada dhe legjenda*, Prishtinë 1974, f. 289-318.

²² U. Sh. T. Instituti i Folklorit, *Folklor shqiptar, I, Proza popullore*, vëllimi i pestë (*Anekdotat*), përgatitur nga Jorgo Panajoti, red. përgjegjës Zihni Sako, Tiranë 1972.

herë aty për aty, nga ndonjëri prej pleqve mendjemprefhtë, në mënyrë të drejtë, dhe pleqnia zente vend. Më vonë, mu këto raste pleqnish, që ndryshonin nga ato të zakonshmet, madje dhe disa raste të tjera që shërbenin si ilustrim për zbatimin e normave të njohura zakonore, u mbajtën mend, u transmetuan gojarisht nga brezi në brez dhe shërbyen si modele për të zgjidhur konflikte të tjera të ngjashme me to, „si motra me to”.

Normat zakonore i përkritnin „legjislacionit” popullor dhe u mbajtën mend e u shfrytëzuan vetëm nga pleqnarët që u muarën drejt për së drejti me pleqni. Përkundrazi, këto raste të rralla zgjidhjesh të konflikteve delikate, si dhe ca shembuj të tjerë që shërbyen si ilustrim i zbatimit të ca normave të caktuara zakonore, u transmetuan, jo në formë të formulave ligjore, të neneve juridike, por në formë të tregimeve popullore. Madje u treguan ndër ndejet e tubimet e burrave, nga njerëz të ndryshëm që nuk ishin pleqnarë, ashtu siç tregoheshin tregimet e tjera popullore, me qëllim që të vihej në pah mendjemprehtësia e pleqnarit që e kishte zgjidhur këtë apo atë pleqni si dhe të theksohej nota didaktike, ashtu siç theksohet dhe në shumë tregime popullore të llojeve të tjera. Me kohë, këto raste të rralla pleqnish, duke u treguar brez pas brezi, u pasuruan me elementet e nevojshme narrative, muarën tiparet e tregimeve dhe u bënë pronë e fondit të prozës popullore, ndonëse ruajtën në thelbin e tyre karakterin juridik, të mbështetur në etikën e ligjëve zakonore. Ndonjë tregim i tillë u huazua gjatë shekujve dhe nga popujt e tjerë, duke iu mveshur petku i ambientit tonë popullor. P. sh. „Gjykimi i Solomonit” tregohet shpesh ndër fshatrat e Kosovës, si tregim origjinal, ndonëse është vetëm një adaptim.

Në popull, këto tregime, me një sfond të së drejtës zakonore, dallohen nga tregimet e llojeve të tjera popullore dhe njihen me termin *pleqni*.

Fatkeqësisht, deri vonë janë botuar fare pak tregime të këtilla, pa u klasifikuar ato në një lloj të veçantë dhe pa u emërtuar me një term më vete. Ndoshta numri i kufizuar i pleqnive të botuara i ka bërë skeptikë dhe i ka penguar studjuesit e folklorit tonë t’i ndajnë këto proza popullore në një lloj më vete. Madje, më sa më është e njohur, vetëm Sh. Gjeçovi, në pjesën „Shtojcë” të Kanunit të Lekë Dukagjinit,²³ na ka lënë ca shembuj të bukur pleqnish. Disa sosh u përgjigjen krejtësisht kërkesave të tregimeve popullore dhe kanë elementet e duhura të kompozicionit. Në kohët e fundit kanë parë dritën dhe nja 42 pleqni, kryesisht të reja.²⁴ Jam i bindur që, në botimet tona të ardhshme materialesh folklorike, do të kemi akoma shembuj të këtillë, të panjohur gjer më sot.

Prandaj, shoh të arsyeshme që paskëtaj duhet t’i pranojmë këto tregime si një lloj më vete të prozës sonë popullore e poashtu t’i emërtojmë në terminologjinë tonë folklorike me termin *pleqni*, aq i përshtatshëm dhe i krijuar nga vetë populli.

7. Ashtu sikurse pleqnitë, që kanë bazën tematike në normat e së drejtës zakonore, poashtu kemi dhe ca proza të tjera popullore që rrahin, ilus-

²³ Shtjefën Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shtojcë, Shembuj nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, f. 113-129.

²⁴ Anton Çetta, *Prozë popullore nga Drenica, II*, Prishtinë 1972, f. 223-245.

trojnë dhe shtjellohen rreth një problemi thjesht etnografik — rreth botë-kuptimesh, traditash, normash shoqërore, besimesh apo bestytinsh. Vetë tregimet e këtij lloji madje duhet të jenë thurur për të ilustruar, për të bërë krejtësisht logjik vetë kuptimin e atyre traditave, normave shoqërore, botë-kuptimeve, për të vënë në pah në mënyrë të dukshme, me anë shembujsh, disa parime etike të shoqërisë të rendit fisnor, si dhe për t'i bërë të bindshme me anë kësi krijimesh folklorike ca besime e bestytini që kishin zënë vend në vetëdijen e njerëzve të thjeshtë në një stad të caktuar të zhvillimit të tyre ekonomik e kulturor.

Siç kam pasë shkruar dhe më parë, „Rreth këtyre problemeve, në popull, ka mendime, gjykime, ligjë kanunorë, rregulla se çfarë qëndrimesh duhen marrë, shpjegime, interpretime gjithfarësh. Të gjitha ato qëndrojnë vetëm gjykime dhe udhëzime të thata të botëkuptimeve në një periudhë të caktuar të zhvillimit shoqëror. Por fshatari ynë nuk është kënaqur vetëm me aq. Për t'i bërë ato dhe më të bindshme, që kështu të mbahen mend, për të theksuar rëndësinë e tyre, i tregon gojë më gojë ngjarjet reale dhe i ilustron me tregime fantastike të tjerat”.²⁵ Tematika e këtyre prozave duhet të jetë mjaft e gjerë. Në një numër relativisht të kufizuar këso prozash popullore të botuara vonë,²⁶ bëhet fjalë ndërmjet të tjerash për hakmarrjen, gjakun e falur, dorëzaninë, besën, burrinë, fjalën e rëndë, modestinë, mikpritjen, grabitjen e vajzës, amanetin, atavizmin, bestytnitë etj. etj.

Është e vërtetë se në shumë krijime folklorike, në poezi apo në prozë popullore, do të gjejmë elemente të shumta që kanë të bëjnë me këto nocione etnografike që janë ilustrime me vend të këtyre koncepteve dhe botëkuptimeve. Por ndër ato krijime, elementet në fjalë na paraqiten si dromca të shpërndara aty këtu, si gjurmë të dhëna për rrëshqit e që nuk përbëjnë thelbin e atyre krijimeve. Përkundrazi, ndër këto proza popullore tregimi shtjellohet konkretisht për të theksuar, për të ilustruar, për të bërë të bindshme idenë kryesore, kategorinë etnografike që konsiston në një normë, botëkuptim, bindje apo besim popullor. Prandaj shoh të arsyeshme që këto proza popullore t'i përfshijmë në një grumbull më vete — si proza që kanë të bëjnë drejtëpërdrejt me një nocion etnografik — dhe t'i quajmë *tregime etnografike*. Vetë ky emërtim madje, më një anë, do të ngërthente e do të shprehte esencën e kuptimit të tyre, ndërsa, në anën tjetër, do të arsyetonte ndarjen e tyre në një lloj të veçantë prozash popullore.

Dhe G. Majeri kishte vënë re diçka specifike në brendinë e dy tregimeve të këtilla, që kanë të bëjnë me besime popullore, dhe i quante „histori shtrigash.”²⁷ Poashtu edhe në përmbledhjen e M. Lambercit „Albanische Märchen”, Wien 1922, disa tregime me brendi të ngjashme do t'i gjejmë të grumbulluara në kapitullin I „Volksglaube (Reste alter Mythologie).”²⁸

Për nga forma tregimet etnografike janë të ngjashme kryesisht me kallëzimet. Ndonjë tregim i tillë, i rrallë, më i shkurtër, është i ngjashëm me anekdotat popullore, ndërsa ca të tjera, që kanë personazhe dhe elemente fantastike, u afrohen përrallave.

²⁵ *Po aty*, f. 27.

²⁶ *Po aty*, f. 195-222.

²⁷ Shih fusnotën nr. 6.

²⁸ Besime popullore (mbeturi nga mitologjia).

b) Llojet minore të prozës popullore

Me këtë term do të përfshijmë krijimet tejet të shkurtëra folklorike, të cilave u mungojnë elementet e tregimit.

1. — a) *Fjalët e urta* janë kryesisht mendime të dendura me përmbajtje didaktike, që mirren si konstatime reale dhe udhëzime të vërteta, fryt i një përvojë të gjatë. Në disa ndër to shprehen njëkohësisht dhe normat e pasqyrohet dhe etika e një shoqërie apo klase në një fazë të caktuar të zhvillimit shoqëror. Zakonisht përmbledhen në një fjali apo periudhë të shkurtër, në formën e një formule koncize në prozë. Një numër shumë më i kufizuar paraqitet dhe në formë distiku apo në një varg të ndarë më dysh, me rimë në mes dhe në fund të tij. Tregohen gjatë bisedës për të ilustruar dhe për të bërë të bindshme tezën që mbron folësi, si dhe në raste të tjera.

b) Të ngjashme për nga brendia me fjalët e urta janë dhe *urtitë popullore*. Edhe këto kanë poashtu përmbajtje didaktike; ilustronjë të vërteta të përgjithshme dhe paraqiten si mendime e gjykime të mprehta, rezultat i përvojës së gjatë jetësore. Ndryshojnë nga fjalët e urta për nga forma. Nuk shprehen me atë koncizitet lakonik të të parave, që u përngjasin formulave të bisedës, por shprehen si mendime të lira, të formuluar në periudha më të gjëra, që her-herë marrin formën e bisedës këshillëdhënëse. Edhe G. Majeri bënte një dallim duke i quajtur „Proverba dhe shprehje proverbiale nga Shkodra”.²⁹

Për të evituar termin „Proverb” dhe „shprehje proverbiale” më duken më të përshtatshme si terma thjesht shqip „fjalë të urta” dhe „urti popullore”, aq të njohura në popull dhe të krijuara nga vetë njerëzit e popullit. Madje termin „fjalë të urta” e gjejmë ç’me kohë në terminologjinë shkencore folklorike, ç’prej trashëgimit shkencor të Hahnit.

Një karakteristikë tjetër e urtive popullore është se ato shpesh janë të lidhura me emrin e një njeriu të dalluar, një plaku mentar, një pleqnari etj. P.sh. Bajram Halili kish pas thanë: „Ma mirë â me kanë i dekën e i gjallë se i gjallë e i dekën, se i pari përmënet, e ky qi â i gjallë s’ka bâ kurr gjâ m’u përmënë për t’mirë, si me kanë i dekën”.³⁰

2. — a) *Kashelashat* ose *gjëegjëzat*, që të dyja terma të njohur në folklorin tonë ç’prej kohësh, duhet të mbesin dhe paskëtaj në terminologjinë shkencore me tagër të barabartë, si terma të krijuar nga vetë populli. Për thjeshtim grafik, analogjikisht me emrin „gjëegjëza” (që më parë shkruhej „gjë e gjëza” e së voni është bashkuar në një fjalë të vetme),³¹ mendoj që duhet të veprojmë dhe me termin e parë, dhe ta shkruajmë „kashelashë-a, shm. -a(t)” e jo „kash’ e lashe” e as „kashëelashe”.

b) Të ngjashme me kashelashat për nga brendia (si enigma folklorike për t’u zgjidhur, në të cilat kërkohet të zbulohet një objekt që, sipas formu-

²⁹ Shih fusnotën 6 dhe 8.

³⁰ A. Çetta, *po aty*, f. 271.

³¹ U. Sh.T. Instituti i Folklorit, *Folklor shqiptar — Gjëegjëza*, Tiranë 1968. dhe Instituti i Folklorit, *Folklori shqiptar*, (tekste për Universitetin), Tiranë 1968.

limit të dhënë në mënyrë përshkruese, përgjason me objektin e paraqitur) janë dhe enigmat popullore dhe problemet popullore ose më drejtë enigmat problemore.

Do të kufizojmë kuptimin e termit *enigma popullore* (i cili në ndonjë botim është dhënë si sinonim i termit „Gjëegjëzë”)³² për ato kashelasha që nuk jipen në formë koncize formulash, qoftë në prozë e qoftë në vargje, por në një mënyrë më të gjatë, tregimtare. Janë, të themi,thurje të vogla folklorike në prozë dhe, si të këtilla, për nga ndërtimi i përgjasin anekdotës. Por u mungon poanta didaktike, humoristike apo satirike, dhënë në një përgjegje të papritur. Qëllimi i enigmave popullore, sikurse dhe i kashelashave, është zbavitës dhe njëkohësisht ato ushtrojnë dhe intuitën. Përposë formës, ato ndryshojnë nga kashelashat e zakonshme dhe për nga objekti që trajtohet në to. Ndërsa në të parat bëhet fjalë për objektet më të ndryshme, ndër enigmat popullore flitet pothuaj krejtësisht për lidhjet e ndërlikuara familjare, farefisnore, që duhen zbuluar dhe, shumë rrallë edhe për ndonjë lojë fjalësh apo kuptim të veçantë që duhet t’i jipet ndonjë fjale. Në blenin „Folklor shqiptar, Gjëegjëza”, Tiranë 1968, f. 531-533, krijimet e këtilla folklorike janë përfshirë në kapitullin „Gjëegjëza problemore”. Pamvarësisht nga emërtimi që nuk më duket shumë i qëlluar, ndarja e tyre në një grup të veçantë është me vend dhe aprovon natyrën e tyre specifike, gjë që bën ato të dallohen nga gjëegjëzat e zakonshme.

c) Një grup tjetër të këtij lloji kashelashash duhet të formojmë dhe për ato krijime të ngjashme folklorike, në të cilat enigma për t’u zgjidhur është dhënë nëpërmjet të numrave. Këto mund t’i quajmë *probleme popullore* (analogjikisht me enigmat popullore) ose *enigma problemore*. Do të preferoja termin „enigma problemore” e jo „gjëegjëza problemore” sepse, për nga ndërtimi i tyre (forma), ato janë më afër enigmave (si krijime tregimtare) se sa gjëegjëzave të dhëna në formula lakonike e koncize.

3. Me emërtimin *pyetjegjegje-a* shm. —, do të përfshijmë ato krijime fare të shkurtëra humoristike dhe didaktike që tregohen në formë dialogu dhe që kufizohen në një (e më rrallë në dy ose tri) pyetje dhe po aq përgjigje.³³ Nga ky neologjizëm i përbërë prej tri pjesësh (pyetje e gjegje > pyetj’ e gjegje) për shkaqe praktike do të formojmë një emër të përngjitur — pyetjegjegje — analogjikisht me gjëegjëzat dhe kashelashat, për të cilat u fol më lart.

4. Janë dhe ca proza, gjatësish të ndryshme, që kanë vetëm karakter zbavitës dhe që kryesisht paraqiten në formë dialogu (shih: „Ç’e bëre mishtë moj nuse” e Mitkos³⁴ si dhe tri proza të ngjashme që i kam shënuar në Drenicë).³⁵ I kam pasë quajtur³⁶ „tregime (lojna) fëmijësh”. Sot do të preferoja termin *proza zbavitëse fëmijësh*, ndërsa, për krijimet e ngjashme popullore në vargje do të përdornim emërtimin „vargje zbavitëse fëmijësh”.

³² Ministrija e Arsimit, Komisioni Teknik, Nr. 20, *Folklorë, vëllim i I*, Tiranë 1939, kaptina II, *Enigma*, f. 22.

³³ Më gjatë shih: A. Çetta, *po aty*, bl. I, f. 26, dhe bl. II, f. 189-193.

³⁴ Instituti i Folklorit, *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*. Tiranë 1961, f. 39.

³⁵ A. Çetta, *po aty*, bl. II, f. 311-313.

³⁶ *Po aty*, bl. I, f. 33.

Megjithatë, për këto krijime dhe për të tjera proza e këngë popullore të ngjashme, ose që kanë ndonjë element të përbashkët dhe që do të duhej të futeshin në të njëjtin lloj krijimesh folklorike, do të bëhet fjalë në ndonjë ndihmesë të veçantë, meqenëse deri më sot për ato nuk është folur fare dhe, në anën tjetër, shembujt e grumbujt e këtyre prozave dhe vargjeve janë më të shumtë dhe më të llojlojshëm se sa mendohet.

5. *Frazeologjizmat*, të njohura gjer vonë në terminologjinë gjuhësore dhe folklorike me emrin *f r a z e o l o g j i*, i ndeshim te folkloristët e vjetër dhe me emërtimet *f r a z a* (Hahni), *f r a z e* (Mitkua) t ë t h ë n a (Dine). Do të përdorim paskëtaj termin frazeologjizma, që u pranua si më i përshtatshëm nga punonjësit shkencorë të Institutit të Gjuhësisë në Tiranë.

Frazeologjizmat, qofshin ato me kuptim të ngushtë linguistik, si nocione të shprehura me lokucione, togfjalësh të qëndrueshëm, në funksione të ndryshme morfologjike, „që kanë vetëm kuptimin e tyre neutral”,³⁷ e s i d o m o s ato në kuptimin letrar, si shprehje më të gjera që ndeshen shpesh në të folmen e popullit, duke filluar që nga shrehjet metaforike, alegorike, krahasimet e deri te fjalët e urta, „që kanë një kuptim figurativ ose një kuptim suplementar metaforik krahas kuptimit neutral”,³⁷ do t'i vlerësojmë si forma të qëlluara të të shprehurit të pasur dhe të figurshëm, të sajuara me plot intuitë e shije kryesisht nga njeriu i thjeshtë i popullit. Si të atilla do t'i konsiderojmë pjesë përbërëse të trashëgimit folklorik. Ato njëkohësisht, sidomos të parat, do të pasurojnë dhe fondin leksikografik. Ndërsa fjalët e rralla, të cilat ka ndodhur t'i gjejmë dhe në ndonjë botim folklorik,³⁸ do të konsiderohen vetëm si pasuri e fondit leksikografik.

6. *Përshtëndetjet* janë shprehje të shkurtëra folklorike dhe thohen në formë të të pyeturit e të dialogut kur dy të njohur takohen. Mjerisht nuk janë mbledhur në një sasi të madhe në kohët më të hershme që t'i kishim në formën e tyre më arkaike, të cilat pa dyshim kanë qenë më të bukura. Sot po shkojnë duke u thjeshtuar dita ditës dhe duke pësuar ndikimin e përshtëndetjeve më të varfëra dhe pjesërisht të huazuara të qytetit.

I gjejmë të shënuara për herë të parë në Fjalorin e Bardhit, gjithsejt nja 7 sosh, në kapitujt: „Salutatio Epiroticae lingua”, f. 217, dhe „Aliae salutationes. . .”, f. 221 të ribotimit, Paris 1932. Mitkua i quante „të përshtëndoshura”. Ne do të përdorim termin p ë r s h ë n d e t j e , a q i njohur dhe i përdorur në jetën e rëndomtë.

7. *Dollitë* për nga forma u afrohen përshtëndetjeve, sepse i drejtohen bashkëfolësit dhe kryesisht zhvillohen në formë dialogu, ndërsa, për nga brendia u afrohen urimeve, sepse në to shprehen dëshira të mira, kushtuar atij që i drejtohem i duke pirë. Shqiptohen duke pirë, në tubime gazmendi — në lindje, fejesa, martesë e festa të ndryshme. Përshtëndetjet më parë

³⁷ Mehmet Çeliku, *Diskutim rreth kumtesës së J. Thomajt „Vëzhgime mbi frazeologjizmat e gjuhës shqipe”, në Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë 1965, f. 363. Shih dhe A. Çetta, Disa frazeologji të Drenicës si rezultate të anekdotave popullore, në Gjurmime Albanologjike — folklor dhe etnologji, I, 1971, f. 119-135.*

³⁸ Ministrija e Arsimit, Komisioni Teknik, Nr. 20, *Folklorë, vëllim i I, Tiranë 1939 kapitulli I Fjalë, f. 5-21.*

ishin shumë të gjata dhe dalloheshin për atë begati shprehjesh të renditura në periudha oratorike. Në disa fshatra të Prespës më ka rënë rasti të dëgjoj dolli në distihe humoristike, të cilat i quanin b e j t e . Tani dollitë po shkojnë duke u thjeshtuar, siç po thjeshtohen dhe ceremonitë e tjera që kanë të bëjnë me të pirët.

8. *Urimet*, krijime shumë të pasura e të llojllojshme folklorike, shprehin dëshirat që u drejtojmë njerëzve të dashur (nëna fëmijëve, gjyshja nipave dhe mbesave, motra vëllezërve dhe motrave etj. etj.). Shumë urime i gjejmë të shprehura sidomos ndër ninullat. Poashtu ato shprehen dhe në shenjë falënderimi për ndonjë mirësi apo shërbim. Janë të pasura dhe plot domethënie urimet që u drejtohen me rastin e lindjes, qoftë ferishtes, qoftë dhe prindërve të tij. Në disa nga këto urime shprehen dëshira që përfshijnë parime etike dhe ideale estetike të shoqërisë.

9. *Ngushëllimet* janë shprehje ngushëlluese që ua drejtojmë të tjerëve për t'ua lehtësuar dhëmbjen me rastin e vdekjes së ndonjë anëtarit të familjes e të farefisit të tyre ose me rastin e ndonjë fatkeqësie të rëndë. Disa ngushëllime shprehen në mënyrë më të fuqishme dhe ndër vajtime.

10. *Betimet* janë formula pak a shumë të caktuara folklorike, që bëhen për t'i bindur të tjerët se akuzat që na drejtohen janë të pavend, qoftë dhe për t'ua mbushur mendjen që të na besojnë për ndonjë çështje që paraqesin. Këto formula njerëzit i shprehin „duke bërë be”. Ndonëse ky lloj krijimesh folklorike në kohët e fundit është duke u zhdukur ose duke u pakësuar në një numër fare të kufizuar, ndër disa lloje të tjera krijimesh folklorike ruhen gjithnjë ca be të kohëve të lashta pagane — beja në tokë, në diell, në hënë, në bukë etj. Betë më të vona u ngarkuan me elemente fetare.

Kur i lëshojmë be dikuj tjetër, duke i drejtuar një lutje, kur „e përbejmë”, qoftë të na tregojë të drejtën, qoftë të ruajë ndonjë fshehtësi, ose kur i kërkojmë ndonjë nderë, atëherë kemi *përbetimet*. Në të vërtetë betimet dhe përbetimet, në esencën e tyre dhe në mjetet shprehëse, nuk kanë ndryshime të mëdha — ndryshimet konsistojnë përgjithësisht në mënyrën e të shprehurit.

11. *Kërcënimet* në të folurit tonë të rëndomtë janë reduktuar në ca formula të thjeshta dhe të zbrazëta. E, pra, në popull mund të gjejmë kërcënime që kanë një fuqi të shprehurit të figurshëm. P. sh. „Mos m'prek se t'prek nana t'ftoftë!” (Drenicë), „Mos m'prekni se jau bie bijat pa kuleç!”³⁹ (Shala e Mitrovicës), „Pak e t'ima!”⁴⁰ (Gjakovë) etj.

12. *Mallkimet* janë shfrime të rrëmbyeshme të njeriut zemërplasur që i drejton një tjetri, duke i dëshiruar ndonjë të keqe. Mallkimet që përdoren

³⁹ Kur vijnë bijat në gjini, gjithnjë sjellin kuleç me vete për vëllezërit e motrat më të vogla dhe për nipat e mbesat. Fëmijët gëzohen shumë, madje dhe që më përpara. „Ka me ardhë dada e me na pru kuleç”, „Na ka pru dada kuleç”. Ose nëna i ngushëllon: „Vjen dada e ju bjen kuleç”. Vetëm kur vdes ndokush në familje, atëherë bijat vinë në gjini të veshura në shenjë zije dhe nuk sjellin me vete kuleç. Kërcënimet „... jau bie bijat pa kuleç!” don të thotë — jau vras ndonjë anëtar të familjes — dhe, kuptohet, bijat me atë rast vijnë në gjini për mort, pra nuk sjellin kuleç.

⁴⁰ Pak fjalë dhe pa e zgjatur shumë (t'ima — të imta) e jo fjalë të mëdha prej arroganti!

sot në të folurit e rëndomtë kufizohen në ca shprehje të shterpëta, ose të ngarkuara me elemente fetare. Përkundrazi, ndër ato më të vjetrat, që i ndeshim aty-këtu në popull, do të gjejmë shprehje të figurshme, krahasime dhe metafora të fuqishme. P. sh. „Tuna mos t'naltë!”⁴¹ (Llap), „T'u rrit' mënja!”⁴² (Gjakovë), „Vofsh poshtë si shpija e madhe!” (Drenicë), „Dy bukë n'ni vën mos i pjeksh!”⁴³ (Deçan), „E kish pas nëmë malsorja t'birin: Heu, bir, jarabi kujtofshin hallku qi kie, e mos paç, edhe kujtofshin qi din, e mos dish!” (Deçan)

13. Ndër shprehjet e figurshme, që janë poashtu krijime të njeriut të thjeshtë të popullit dhe që pasurojnë fondin folklorik, do të shtija dhe *eufemizmat* popullore — forma të zbutura të të shprehurit, për të evituar emrin e vërtetë që mund të ketë ndjellë frikë, neveri dhe mospërfillje. Kështu p.sh. për të mos përmendur emrin e dreqit, në popull dëgjohet eufemizmi „shkoftë largti”, „i koftlargti” ose „hângt gur e kërsh”, ndërsa për rrufenë do të gjejmë *perifrazën* „pushka e zotit”⁴⁴ etj. etj.

Llojet minore të prozës popullore, me përjashtim të fjalëve të urta dhe kashelashave, fatkeqësisht, janë mbledhur fare pak e aspak. Kur të kemi një fond më të pasur nga këto krijime folklorike, të cilat, ndonëse të shkurtëra, fare të shkurtëra, kanë bukurinë e tyre të të shprehurit artistik, atëherë do të bindemi që ato vlejné t'u kushtojmë një kujdes më të madh dhe studime të veçanta.

Sa u përket *kujtimeve*, të cilat u përmenden më lart, ato mund të mirren si dëshmi historike dhe do të pasurojnë fondin e arkivave historikë, ndërsa *bestytnitë* duhet të mblidhen si materiale etnografike.

Një ndarje e tillë, më e gjerë, mendoj që do t'u shërbente si orientim dhe bashkëpunëtorëve të terrenit që t'i mbledhin me insistim të gjitha këto lloje të prozës popullore dhe të pasurojnë kështu fondin e çdonjërit lloj, qoftë të tregimeve, qoftë të llojeve minore të prozës popullore, sepse çdo krijim folklorik ka rëndësinë e vet dhe do t'u shërbejë më vonë, në një mënyrë ose në një tjetër, studjuesve të folklorit tonë dhe pasurimit të gjuhës.

Në anën tjetër, angazhimi rreth rrahjes së këtij problemi edhe paskëtaj nga studjuesit e folklorit tonë duhet të përsëndetet. Jam i bindur që ai angazhim do të kontribuojë për zgjidhjen sa më të drejtë të ndarjes së prozës sonë popullore dhe emërtimeve sa më të qëlluara të llojeve të saj, që meritojnë t'u kushtohet kujdesi i duhur.

⁴¹ Shkofsh e humbsh përtej Danubit!

⁴² Si fjalë e urtë ky mendim shprehet: „Mallkimi ma i madh — t'u rrit' mënja”

⁴³ Ky mallkim u drejtohet vajzave gjer sa janë të pamartuara, dhe ka kuptimin: „Të vdekshin burrat dhe ndërrofsh shtëpi herë pas here!”

⁴⁴ Shih këngën kreshnike „Halili merr Begzaden e Bardhë” në botimin e Instit. Alban. të Prishtinës, *Balada dhe legjenda*, Prishtinë 1974, f. 17:

*Fushë e bjeshk-o po shkojnë tuj gjimue
sikur deti pej tallazev' t'mdha
sikur qella pej pushkës së zotit
ditve t'kqija qi shum herë e shpráz. . .*

Anton Çetta

POUR UNE CLASSIFICATION PLUS COMPLETE DE LA PROSE POPULAIRE
ET LA DENOMINATION DE CERTAINS GENRES

R é s u m é

Le problème de la classification de la prose populaire albanaise jusqu' à la Deuxième Guerre mondiale n'a pas été traité de façon rationnelle. Par contre, la classification ainsi que la dénomination des genres de la prose populaire ont été faites par des folkloristes albanais et étrangers, par degrés et de temps à autre, selon le besoin qu'ils en avaient, en recueillant eux-mêmes des matériaux folkloriques en prose.

Après la Deuxième Guerre mondiale, en même temps que les autres études analytiques sur le folklore albanais en général, une nouvelle classification de la prose albanaise a été réalisée par les savants albanais, outre les études particulières, dans deux éditions normatives: *Historia e letërsisë shqipe, I, Pjesa e parë — Folklori shqiptar, Tiranë 1972*, ainsi que dans le manuel universitaire: *Folklori shqiptar, Tiranë 1972*. Dans ces deux éditions, la classification de la prose populaire est faite selon un critère scientifique plus rigoureux et présente un progrès à la solution de ce problème du folklore albanais.

Pendant le travail d'investigation sur le terrain, surtout les 15-20 dernières années, on a recueilli de vastes matériaux folkloriques en prose, soit en Albanie, soit parmi les Albanais en Yougoslavie. Une grande partie de ces matériaux ne nous était pas connue jusqu' à aujourd'hui. Les lacunes et les erreurs concernant les classifications et les dénominations antérieures, ainsi que les nouveaux matériaux, découverts ces dernières années sur le terrain, nous imposent, encore une fois, comme une urgente exigence scientifique, le traitement à part de cette question. Ce problème surgit à l'occasion de la publication systématique du folklore albanais, soit par l'Institut de Folklore de Tirana, soit par l'Institut d'Albanologie de Prishtina.

Dans le présent sujet on traite d'une manière succincte tous les genres de la prose populaire en insistant particulièrement sur les genres qui, selon l'auteur, doivent subir certains changements, soit dans leur dénomination, soit dans la classification en sous-groupes du genre-même. L'auteur croit également que les nouvelles populaires, les contes du droit coutumier et les contes ethnographiques doivent être considérés comme des genres à part dans le cadre de la prose populaire. Il en est de même pour une partie considérable d'autres créations folkloriques des genres mineurs de la prose populaire, qui n'ont pas été traités jusqu' à présent dans les éditions normatives du folklore albanais.